VENDIM
Nr. 260, datë 2.12.2024

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË "DESLA" SHPK PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa "a", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa "a", 5, pika 1, germa "a", dhe 10, pikat 1 dhe 3, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa "a" të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 2.12.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2426/1 prot., datë 27.11.2024, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve "Mbi kërkesën e shoqërisë 'Desla' sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike",

konstatoi se:

- Shoqëria "Desla" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2426 prot., datë 20.11.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet prodhues 3 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 8517, Bashkia Durrës, qarku Durrës.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, germat "a" "b" dhe "c"; për pikën 1.2, germat "a", "b", "c" dhe "d"; për pikën 1.3, germat "a", dhe "c"; për pikën 2.1, germat "a", "b", "c", "d", "e" dhe "f".

- Rezulton se shoqëria "DESLA" sh.p.k.:

- Ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), kontratën nr. 3139 rep., nr. 2348 kol., datë 16.9.2024, "Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 3 mw, dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni, në zonën kadastrale nr. 8517, Bashkia Durrës, qarku Durrës";

- Ka depozituar shkresën e shoqërisë "Operatori i Sistemit të Shpërndarjes" (OST) sh.a. nr. 2981/3 prot., datë 30.3.2023, për miratimin e pikës së lidhjes së centralit me rrjetin e shpërndarjes;

- Është pajisur me vendim për VNM paraprake, lëshuar më datë 11.7.2023 nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për të zhvilluar projektin "Ndërtimi i centralit fotovoltaik Desla Solar, 3 mw". Kjo VNM është aktualisht e vlefshme (deri më 11.7.2025), dhe në kuadër të fillimit të zbatimit në terren të projektit, shoqëria ka informuar se është në pritje të zbardhjes së lejes së ndërtimit.

- Nga ky aplikim nevojitet të plotësohet dhe informacioni/dokumentacioni në vijim:

NENI 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1, Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë.

Pika 1.3, Dokumentacioni financiar dhe fiskal.

germa "b": Shoqëria duhet të depozitojë në ERE vendimin e organeve drejtuese të saj, ku të përcaktohet shuma që dedikohet për projektin fotovoltaik, në referencë kjo të vlerës së mbetur për investimin e plotë të projektit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "Desla" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet prodhues 3 mw, në zonën kadastrale nr. 8517, Bashkia Durrës, qarku Durrës, për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë "Desla" sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti